



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.996/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “New Co Aromatik” shpk, me nr. Biznesi 70280741, me seli ne Prizren rr. “Tirana” pn, Zona Industriale, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson T. H. avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Telekom i Kosovës sh.a me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1444/22 dt.30.05.2023, me datën 08.12.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e kreditorit “New Co Aromatik” shpk, me nr. Biznesi 70280741, me seli ne Prizren rr. “Tirana” pn, Zona Industriale, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1444/22 dt.30.05.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1444/22 dt.30.05.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës sh.a me seli ne Prishtinë, i ushtruar ndaj urdhrit përmbarimor P.nr.463/21 dt.03.11.2021 i lejuar nga përmbaruesja private Rrezarta Metaj, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.463/21 dt.03.11.2021.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes se dispozitave procedurale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe ta detyroj debitorin te paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “New Co Aromatik” shpk, me nr. Biznesi 70280741, me seli ne Prizren rr. “Tirana” pn, Zona Industriale, me datën 02.11.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Telekom i Kosovës sh.a me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave me nr.43/21 dt.05.04.2021, 60/21 dt.03.05.2021, 72/21 dt.01.06.2021, 85/21 dt.02.07.2021, 98/21 dt.01.08.2021, 110/21 dt.01.09.2021. Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.463/21 dt.03.11.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga faturat t’i paguaj shumën prej 6,000.00 euro, me kamatë prej 8% duke llogaritur nga dita e rënies ne vonesë e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet tjera te procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori, me datën 10.11.2021 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se propozimit për përmbartim kreditori nuk i ka bashkangjitur fare faturat ne origjinal e as kopje te vërtetuara dhe se te njëjta nuk janë te nënshkruara, urdhri për caktimin e përmbartimit është i pabazuar dhe se nuk ka titull ekzekutiv. Debitori e konteston ne tërësi urdhrin përmbartimor si te kundërligjshëm dhe se përmbartuesi privat duke shkelur kompetencat ka vepruar kur ka lejuar përmbartimin ashtu qe bazuar ne këtë gjendje faktike dhe ne bazë te nënti 73 par.1 te LPP debitori propozon qe gjykata te caktoj seancë publike me qellim te kuptimit te validitetit te prapësimit. Shton se nga data 07.05.2021 zyrtaret e PTK nuk kanë pasur qasje ne hapësirat me qira dhe pajisje dhe pas pagesës se qirasë qiradhënësi na ka lejuar qasje ne objekt dhe te nesërmen janë tërhequr pajisjet qe deri ne atë kohë ka qenë jashtë funksionit. Debitori ne vazhdimësi ka kërkuar marrëveshje për te mundësuar tërheqjen e pajisjeve te BTS pz aromatiku dhe i referohet korrespondencave, andaj propozon qe gjykata ta pranoj si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ta obligoj kreditorin ti barte shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 16.11.2021 ka ushtruar kreditori, me pretendimin se prapësimi i debitorit është i pabazuar, nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit dhe na ne prapësim sepse me njoftimin e datës 07.04.2021 për shkëputjen e kontratës se qirasë është thënë qe Telekom i Kosovës do te përmbush te gjitha obligimet nga kontrata deri me dt.07.05.2021, hapësira e marrë ne shfrytëzim dhe me qira është shfrytëzuar nga debitori deri me datën 20.09.2021, shton se përmbartimi është lejuar ne bazë te faturave ne origjinal qe i ka pranuar debitori dhe për këtë i paraqes i referohet dëftesave te postes, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar prapësimin e debitorit, urdhri përmbartimor te mbetet ne fuqi dhe te detyrohet debitori te paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerçiale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1444/22 dt.30.05.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka

theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar sepse faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente te besueshme nga neni 29 par.3 te LPP, sepse nuk mund te vërtetohet qe faturat janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori dhe se te njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e protokollit te debitorit. Gjykata nuk i konsideron si te përshtatshme për përmbartim faturat e lartcekura përderisa nuk ka prova përmes se cilave vërtetohet se debitori është njoftuar ne mënyrë te rregullt dhe se te njëjtat i ka pranuar duke mos e kundërshtuar detyrimin qe rrjedh nga to. Gjykata kufizohet ne vlerësimin e kushteve formale sa i përket ligjshmërisë se urdhrin përmbartimor ndërsa pretendimet e natyrës materiale për mos përmbushje te kontratës se qirasë kreditorit mund ti paraqes ne kontest te rregullt civilo-juridik, andaj mbi këto arsye edhe ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave nr.43/21 dt.05.04.2021, 60/21 dt.03.05.2021, 72/21 dt.01.06.2021, 85/21 dt.02.07.2021, 98/21 dt.01.08.2021, 110/21 dt.01.09.2021, te lëshuara nga kreditori.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës se dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata e shkalles e dytë konsideron se faturat si dokumente ne sajë te cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk i plotësojnë arsyet ligjore për tu konsideruar si dokumente te besueshme, te parapara edhe me nenin 29 par.3 te LPP i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*. Andaj, këto fatura si te tilla nuk janë te përshtatshme për përmbartim, sepse te njëjtat janë te panëshkruara nga debitorit dhe te pavulosura nga ana e tij.

Kjo gjykatë i shqyrtoi pretendimet ankimore sa i përket pretendimit te palës kreditore se faturat janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori dëftesat e te cilave ia ka prezantuar gjykatës, kjo gjykatë i vlerësoi si te pabazuara sepse nga këto dëftesat e postes nuk mund te konstatohet saktë së debitori i ka pranuar ne mënyrë te rregullt faturat pasi te njëjtat janë te panëshkruara dhe pavulosura nga debitori dhe se ne lende nuk ka prova se këto fatura janë pranuar nga debitori. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera te kreditorit por vlerësoi se te njëjtat nuk janë relevante për një vendosje ndryshe sepse nuk i ka argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP , te cilat kjo gjykatë i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e gjykatës se shkallës se parë e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.996/23, me datë 08.12.2023

Gjyqtari,  
Dren Rogova